



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

RAPORT ME REKOMANDIM

A.nr.503/2015

Albert Lekaj

lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.1926/14

**Për: Z. Hasan Shala, Kryetar
Gjykata e Apelit**

Prishtinë, më 1 dhjetor 2017

Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Gjykatës së Apelit të Kosovës, lidhur me nevojën e ndërmarjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC.1926/14, pa vonesa të mëtutjeshme.
2. Ky raport është i bazuar në ankesën individuale të z. Albert Lekaj (në tekstin e mëtejme *ankuesi*) i cili në bazë të nenit 16.1, të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, më 25 shtator 2015, parashtroi ankesë kundër Gjykatës së Apelit të Kosovës, për shkak të zvarritjes së procedurës gjyqësore në lëndën AC.1926/14.
3. Ngjarja mbështetet në faktet dhe provat e ankuesit, si dhe nga shkresat tjera të cilat i posedon Institucionit i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore në lëndën e pazgjidhur të ankuesit të proceduar në gjykatë nga 14 janari i vitit 2002, e cila deri në publikimin e këtij raporti nuk ka ndonjë vendim përfundimtar.

Baza ligjore

4. Sipas nenit 135, para. 3 të Kushtetutës: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
5. Po ashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16 paragrafi 8, përcakton se: *“Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave”.*

Përmbledhja e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat me të cilat posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), mund të përmblihen si në vijim:

6. Më 14 janar 2002, i ati i ankuesit (kryefamiljar) kishte parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë (tash Gjykata Themelore) kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) SH.A. në Prishtinë, me kërkesë që në emër të kompensimit material për djegien e shtëpisë (ngjarje e ndodhur më 23 maj 2001), t’ia kompensoj dëmin në vlerë prej pesëdhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e pesë euro (53.335, €).
7. Më 27 prill 2010, Gjykata Komunale në Gjakovë nxjerri *Aktgjykim C.nr.219/2007*, me të cilin pjesërisht e aprovoi kërkesëpadinë e ankuesit, duke e detyruar të paditurën t’ia kompensoi paditësit shumë prej njëzet e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre euro (28.563, €), së bashku me kamatën përkatëse ligjore të cilën e paguajnë Bankat Komerciale në Kosovë në mjetet e deponuara në bankë në afat mbi një vit pa destimin të caktuar, duke filluar të rrjedhë nga data 14 janar 2002.
8. Më 19 dhjetor 2010, i autorizuari i ankuesit brenda afatit ligjor parashtroi ankesë kundër pjesës refuzuese të *Aktgjykimit C.nr.219/2007, datë 27 prill 2010*.
9. Më 23 dhjetor 2010, edhe e paditura brenda afatit ligjor parashtroi ankesë duke e ankimuar në tërësi *Aktgjykimin C.nr.219/2007, datë 27 prill 2010*.
10. Më 1 tetor 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë nxjerri *Aktvendimin Ac.nr.68/2011*, me të cilin e prishi *Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë C.nr.219/2007, të datës 27 prill 2010* dhe çështjen e kthej te e njëjta gjykatë për rishqyrtim dhe rivendosje.

11. Më 29 nëntor 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë, nxjerr *Aktgjykim C.nr.325/12*, me të cilin sërish e aprovon pjesërisht kërkesëpadinë e ankuesit.
12. Më 5 dhjetor 2013, i autorizuari i ankuesit brenda afatit ligjor parashtroi ankesë kundër *Aktgjykimit C.nr.325/12, të datës 5 dhjetor 2013* dhe prej atëherë lënda gjindet në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit

13. Më 9 nëntor 2015, Avokati i Popullit i dërgoi shkresë ushtrueses së detyrës së kryetarit të Gjykatës së Apelit, nga e cila kërkoi informacione relevante përkitazi me zhvillimet e ngjarjes në çështjen e ankuesit.
14. Më 24 nëntor 2015, Avokati i Popullit mori përgjigje nga ushtruesja e detyrës së kryetarit të Gjykatës së Apelit, e cila njoftoi se lënda AC 1926/2014, ka mbërritur në këtë gjykatë me 28 maj 2014, është ndarë në punë dhe do të procedohet sipas radhës, duke theksuar se gjykata në këtë periudhë po shqyrton me prioritet të gjitha lëndët e vitit 2013.
15. Më 22 shtator 2016, Avokati i Popullit i dërgoi shkresë ushtrueses së detyrës së kryetarit të Gjykatës së Apelit, nga e cila kërkoi informacione relevante përkitazi me zhvillimet e ngjarjes në çështjen e ankuesit.
16. Më 28 tetor 2016, Avokati i Popullit mori përgjigje nga ushtruesja e detyrës së kryetarit të Gjykatës së Apelit, e cila njoftoi se lënda AC 1926/2014, ka mbërritur në këtë gjykatë me 28 maj 2014, është ndarë në punë dhe pret në radhë për vendosje, duke theksuar se gjykata në këtë periudhë po përballet me numër të madh të lëndëve civile.
17. Më 30 maj 2017, Avokati i Popullit i dërgoi shkresë kryetarit të Gjykatës së Apelit, nga i cili kërkoi informacione relevante përkitazi me zhvillimet e ngjarjes dhe arsyet e zvarritjes në çështjen e ankuesit.
18. Më 16 qershor 2017, Avokati i Popullit mori përgjigje nga kryetari i Gjykatës së Apelit, i cili lidhur me lëndën AC 1926/2014, njoftoi : *“Kjo lëndë ka ardhur në Gjykatën e Apelit me 28 maj 2014. Është ndarë në punë dhe pret në radhë për vendosje”*

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

19. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21 thekson: *“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, [...]”*
20. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, përcaktohet me nenin 31. të Kushtetutës: *“Çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*
21. Përveç nenit 31 të Kushtetutës, e drejta për proces të rregullt ligjor, nënkuptohet edhe nga nenet 30 dhe 32. Këto dy nene e mbrojnë këtë të drejtë duke përcaktuar të drejtat e të akuzuarit në një proces gjyqësor, dhe të drejtën për mjete juridike, e që të tri këto nene së bashku i përcaktojnë elementet bazë të konceptit të procesit të rregullt ligjor.
22. Po ashtu, Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut garantohet me nenin 54 të Kushtetutës:

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

23. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) është dokument ligjor i zbatueshëm drejtpërdrejtë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike¹. Prandaj, paragrafi 1 i nenit 6 i KEDNJ-ë garanton që: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njëri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm kohor”*.
24. Ligji për Gjykatat, nr.03/L-199, neni 7, paragrafi 2, përcakton: *“[...] Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.”*

Analiza ligjore

25. Duke pasur parasysh çështjen e ankuesit, lidhur me dështimin e gjykatave për të vendosur lidhur me rastin e tij, Avokati i Popullit vëren se e drejta për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm dhe e drejta për mjete efektive juridike, nuk është përmbushur, pasi gjykatat kanë zvarritur vendosjen e lëndës së ankuesit për rreth gjashtëmbëdhjetë (16) vite, procedurat e së cilës janë iniciuar që nga viti 2002 dhe ende nuk janë vendosur përfundimisht (*deri në ditën e nxjerrjes së këtij raporti*) dhe se zvarritjet e tepruara të procedurave gjyqësore dhe pa një vendim përfundimtar të formës së prerë, janë në kundërshtim me të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me nenin 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ.
26. Në raste të shumta, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor, paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
27. Avokati i Popullit përkujton që e drejta precedente e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ka vërtetuar që për rastet ku përfshihet përcaktimi i të drejtës penale, zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore (*shih aktgjykimin Boddaert kundër Belgjikës, më 12 tetor 1995, paragrafi 35*).
28. Avokati i Popullit, po ashtu përkujton se neni 6 (1) i KEDNJ nuk parasheh ndonjë afat absolut për përcaktimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës, por ai përcaktim varet nga rrethanat e veçanta të rastit, veçanërisht nga ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e palëve dhe autoriteteve të përfshira, si dhe prej asaj se çfarë është në interes për ankuesin.
29. Sipas GJEDNJ-së, është e domosdoshme të bëhet një vlerësim i përgjithshëm i procedurave me qëllim të përcaktimit të arsyes për zgjatje të procedurës. Kjo do të thotë që, vonesat e caktuara lidhur me një pjesë të procedurave mund të mos përbëjnë shkelje nëse zgjatja e tërësishme e procedurës nuk ka qenë e tepruar.
30. Megjithatë, Avokati i Populli përkujton se sipas të drejtës precedente të GJEDNJ-së, “arsyeshmëria” e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet duke iu referuar kriterëve si në vijim: ndërlikueshmëria e rastit, sjelljet e aplikuesit dhe të autoriteteve

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22

përkatëse dhe se çfarë ishte në rrezik për aplikuesin në çështjen në fjalë” (GJEDNJ [Dhoma e Madhe], *Frydlender v. France*, Aplikimi Nr. 30979/96 (2000), par. 43, duke cituar GJEDNJ [Dhoma e Madhe], *Comingersoll S.A. v. Portugal*, Aplikimi Nr. 35382/97, par. 19 (2000), par. 19).

31. Avokati i Popullit përkujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit vendor ligjor (*shih p.sh. Aktgjykimin në rastin Bottazi kundër Italisë, më 28 korrik 1999, paragrafi 22.; dhe Aktgjykimin në rastin Di Mauro kundër Italisë, më 28 korrik 1999, paragrafi 23*).
32. Në vendimet e saj, GJEDNJ ka theksuar se autoritetet gjyqësore duhet t’u japin vëmendje të veçantë rasteve ku interesi në fjalë është me rëndësi jetësore për aplikuesin (*shih, p.sh. GJEDNJ, Doustaly v. France, Rasti Nr. 26256/95 (1998), par. 48*).
33. Prandaj, në rastin në fjalë, Avokati i Popullit rithekson se, periudha përkatëse për t’u shqyrtuar lënda e ankuesit fillon prej 14 janarit të vitit 2002, data kur i ati i ankuesit si kryefamiljar paraqiti padinë në gjykatën Gjykatën Komunale në Gjakovë (tash Gjykata Themelore) dhe ende nuk është marrë vendim përfundimtar lidhur me rastin, data e fundit e hetimit të këtij rasti në shqyrtim, konsiderohet data e publikimit të këtij raporti. Prandaj, Avokati i Popullit konstaton se procedurat kanë zgjatur rreth gjashtëmbëdhjetë (16) vite.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

34. Nisur nga analiza e informatave, dëshmive dhe fakteve në dispozicion, Avokati i Popullit vëren se për rastin në fjalë, periudha përkatëse për t’u shqyrtuar lënda e ankuesit fillon prej 14 janarit 2002, data kur është parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë me kërkesë që në emër të kompensimit material për djegien e shtëpisë (ngjarje e ndodhur më 23 maj 2001), e paditura t’ia kompensoj dëmin e deri në publikim e këtij raporti gjykata nuk arrit të lëshojë një vendim përfundimtar.
35. Prandaj, Avokati i Popullit konstaton se procedurat kanë zgjatur rreth 16 vjet dhe ende nuk ka një vendim përfundimtar, prandaj kjo vendimmarrje e gjykatave paraqet dështim në vendosjen përfundimtare të rastit, në dëm të ankuesit dhe dështim për mbrojtje gjyqësore të drejtave të njeriut të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
36. Avokati i Popullit përkujton se gjykata ka për detyrë që procedura gjyqësore të zbatohet, pa ndonjë zvarritje të paarsyeshme. Nga informatat në dispozicion nuk ka ndonjë nderlikueshmëri apo kompleksitet tjetër të çështjes e cila ka kontribuar në çfarëdo zvarritje të procedurës, ndërsa zvarritjet pa një vendim përfundimtar, i kanë kontribuar shkeljeve të drejtave për mbrojtje gjyqësore, në dëm të ankuesit. Kjo mënyrë e veprimit të gjyqësorit dëshmon për mohimin e drejtësisë dhe ligjshmërisë për mbrojtje gjyqësore të të drejtave
37. Avokati i Popullit konstaton që në rastin konkret **ka pasur shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me aktet ligjore të lartpërmendura në çështjen në fjalë.**

Prandaj, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “[...] *Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore*”, dhe nenin 16, paragrafi 8 të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit “*Avokati i Popullit mund të jap rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësorë. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe procedurat tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurës*”, bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës:


Rekomandon

Gjykatën e Apelit të Kosovës

- *Që pa vonesa të mëtutjeshme t’i ndërmerr të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës AC.1926/14.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,



Hilmi Jashari
Avokat i Popullit